

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT			
MINISTRIA E FINANCËVE-MINISTARSTVO ZA FINANSIJE-MINISTRY OF FINANCE			
Njësia Org. Org. Unit	06/4/40	Prot. No. 987/2026	
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	8	Data Datum Date: 15.05.26	
PRISHTINË/PRISTINA / PRISHTINA			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije/ Ministry of Finance

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATË/A:	15.05.2026
PËR/ZA/TO:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Sekretarët e Përgjithshëm, Kryeshefat e Agjencive, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar
NGA/OD/FROM:	Hekuran Murati, Ministër i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2027/01

Të nderuar,

Me lejon t'ju shpreh falënderimin tim për kontributin tuaj të çmuar në hartimin e projeksioneve buxhetore për periudhën 2027–2029, të cilat përbëjnë bazën për përgatitjen e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2027.

Në vijim, ju përcjellim Qarkoren Buxhetore 2027/01, e cila përmban kufijtë fillestarë buxhetorë për secilën Organizatë Buxhetore në nivel qendror, si dhe kufijtë buxhetorë për nivelin komunal për periudhën 2027–2029.

Ministria e Financave mbetet në dispozicionin tuaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të Projektligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2027.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

Me respekt!

Hekuran Murati
Ministër i Financave



Qarkorja Buxhetore 2027/01

1. Qëllimi

Në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministri për Financa është i autorizuar dhe përgjegjës të lëshojë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri lëshon Qarkoren Buxhetore 2027/01, e cila përmban udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2027, si dhe vlerësimet për vitet 2028 dhe 2029. Kjo qarkore përfshin gjithashtu kalendarin kohor indikativ për procesin buxhetor dhe kufijtë fillestarë buxhetorë për vitin 2027, përkatësisht vlerësimet për vitet 2028-2029 për secilën organizatë buxhetore.

Në rast nevojë, pas kësaj qarkoreje do të lëshohen edhe qarkore të tjera plotësuese deri në finalizimin e plotë të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2027 dhe vlerësimeve për vitet pasuese.

2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2027-2029

Planifikimi i buxhetit për vitin 2027 mbështet në prioritetet qeveritare dhe kornizën makro-fiskale. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrahë kërkesat e organizatave buxhetore, në përputhje me orientimet sektoriale buxhetore dhe prioritetet e përcaktuara.

Objektivat strategjike të Qeverisë janë përcaktuar përmes Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, dhe strategji sektoriale, si dhe nëpërmjet dokumenteve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian, si Programi për Reforma në Ekonomi 2026-2028 dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Prioritetet e Qeverisë për periudhën trevjeçare të ardhshme përqendrohen në ri-orientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjen e punësimit, dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, që mbrojnë mjedisin dhe sigurojnë ruajtjen e tij për brezat e ardhshëm. Po ashtu, një tjetër prioritet është orientimi drejt transformimit digjital.

Projeksionet fiskale kanë përcaktuar burimet e mundshme të financimit që Qeveria mund të disponojë për shpenzime në vitin 2027, si dhe vlerësimet për vitet 2028-2029. Çdo tejkalim i kufijve të shpenzimeve të përcaktuara në këtë qarkore do të bëjë të detyrueshëm ndryshimin e burimeve të financimit, përfshirë mundësinë e rritjes së burimeve të financimit dhe/ose ndryshimin e politikave tatimore për të siguruar të hyra shtesë.

Gjatë procesit të hartimit të buxhetit, duhet të merren parasysh zotimet tona ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Qarkorja Buxhetore 2027/01 është hartuar në përputhje me obligimet e deritanishme nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe ato në proces negociate, duke pasqyruar përkushtimet për politikën fiskale në përputhje me kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2027

Para dorëzimit të kërkesave buxhetore për vitin 2027, organizatat buxhetore duhet t'i paraqesin Ministrisë së Financave parashikimin e realizimit të buxhetit për vitin 2026 deri në fund të vitit, në nivel të programeve, nënprogrameve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve individuale. Gjithashtu, organizatat buxhetore obligohen të identifikojnë dhe të informojnë Ministrinë për çdo nënshpenzim të mundshëm në buxhetin aktual, si dhe për pritjet lidhur me mbishpenzimet, para dorëzimit të kërkesave buxhetore për vitin 2027 dhe vlerësimeve për vitet 2028–2029.

4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2027-2029

Procesi buxhetor për vitet 2027-2029 ka për qëllim të lidh planet dhe politikat buxhetore me prioritetet e Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo është realizuar duke prioritetizuar sektorët buxhetorë sipas projeksioneve për periudhën 2027-2029. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e paraqitura, duke detajuar përgatitjen e buxhetit në nivelin e programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të paraqiten vetëm nëse ka hapësirë fiskale të lirë dhe nëse ato janë përfshirë në projeksionet për periudhën 2027-2029. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave duhet të sigurohet që totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori të mos e kalojë shumën e parashikuar në projeksionet për sektorin për vitet 2027-2029.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre, t'u japin prioritet:

- Projekteve që kontribuojnë në realizimin e prioritetëve të Qeverisë dhe dokumenteve strategjike;
- Projekteve që janë në vazhdimësi nga vitet e kaluar dhe kanë obligime kontraktuale, përfshirë edhe ato të shpronësimit të lidhura me këto projekte;
- Zotimeve të Qeverisë për Planin e Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe për programin Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA);
- Legjislacionit të ri ose ndryshimit dhe plotësimit të legjislacionit ekzistues;
- Obligimeve për financim të jashtëm për projekte individuale, të cilat duhet të përfshihen brenda ndarjeve buxhetore dhe
- Aktivitet të cilat kanë të bëjnë me Agjendën e reformave në kuadër të Planit të Rritjes.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimi i qasjes së buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar në planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi në formë tabelare i burimeve të financimit dhe strukturës së shpenzimeve sipas kategorive për vitin 2027, si dhe projeksioneve për vitet 2028–2029.

Gjatë procesit buxhetor, organizatat buxhetore (OB) në nivel qendror dhe lokal duhet t'i kushtojnë vëmendje të shtuar zbatimit të çështjeve në vijim:

- OB-të nuk duhet të propozojnë aktivitete apo projekte të reja pa i dhënë përparësi financimit të obligimeve ekzistuese, veçanërisht projekteve kapitale. Në përputhje me rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit, OB-të duhet të dërgojnë në Ministrinë e Financave informata lidhur me paditë e ngritura, së bashku me vlerësimin ligjor për mundësinë e shndërrimit të tyre në obligime financiare;
- OB-të janë të obliguara të plotësojnë me saktësi të dhënat në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP dhe të parandalojnë keqklasifikimin e shpenzimeve. Në rast të identifikimit të

keqklasifikimeve nga analisti buxhetor gjatë shqyrtimit të propozim-buxhetit, Departamenti i Buxhetit do t'i eliminojë ato, përfshirë edhe projektet ekzistuese dhe ato të reja;

- Projektet kapitale duhet të jenë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Projektet që nuk i përmbushin kriteret dhe standardet ligjore nuk do të përfshihen në buxhet;
- Për çdo projekt të ri kapital, OB-të obligohen të dorëzojnë arsyeshmërinë përkatëse në Ministrinë e Financave, në përputhje me rregullat e sistemit PIP dhe udhëzimet administrative në fuqi;
- OB-të duhet të sigurojnë regjistrimin e zotimeve shumëvjeçare në sistemin PIP dhe SIMFK. Ministrinë duhet të ndajnë mjete buxhetore vetëm për projektet për të cilat ekzistojnë marrëveshje paraprake dhe obligime të krijuara në të kaluarën me komunitat;
- Buxheti i projekteve kapitale duhet të përfshijë edhe shpenzimet e shpronësimit si pjesë e kostos totale të projektit. Nuk lejohet planifikimi i linjave të veçanta buxhetore për shpronësim;
- Për projektet e reja kapitale të teknologjisë së informacionit, OB-të duhet të marrin paraprakisht miratimin nga Agjencia e Shërbimeve të Informacionit (ASHI/MPB), duke konfirmuar se projekti nuk mund të realizohet nga ASHI.

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim arritjen e prioritetëve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe duke zhvendosur buxhetin nga një organizatë në tjetrën të nivelit qendror, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë dhe të fokusohen në fushat e politikave sektoriale, në përputhje me prioritetet e Qeverisë.

Shpenzimet rrjedhëse: Organizatat buxhetore duhet të paraqesin kërkesat e tyre brenda kufizimeve buxhetore të caktuara. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore të respektojnë kufijtë e përcaktuar në shtojcat e bashkangjitura.

Punësimi: Pozitat e reja do të lejohen vetëm brenda numrit të aprovuar të pozitave dhe buxhetit për pozitat e paplotësuara sipas udhëzimeve të dhëna me qarkore.

Pagat dhe shtesat: Për kalkulimin e pagave për vitin 2027 për pozitat aktuale është marrë për bazë për llogaritje muaji prill 2026 duke përfshirë rritjen në bazë të përvojës së punës, në masën zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune. Ndërsa për punëtorët e papunësuar është përllogaritur paga mesatare dhe është buxhetuar vetëm deri 40%, brenda kufizimeve buxhetore.

Mallrat dhe shërbimet: Organizatat buxhetore do të kenë mundësi të sigurojnë financim për fushat prioritare dhe thelbësore. Ato duhet të identifikojnë burime brenda skenarëve të tyre bazë, duke i rialokuar nga fushat me performancë të ulët ose nga ato që nuk përputhen në masë të mjaftueshme me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Shpenzimet komunale: priten të ketë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2026.

Subvencionet dhe transferet: Në kuadër të kësaj kategorie do të vazhdojë ndarja e mjeteve për zbatimin e skemave sociale dhe pensionale, duke përfshirë rritjen natyrore të skemave pensionale, subvencionet në sektorin e bujqësisë, si dhe zbatimin e politikave të reja tashmë të miratuara nga Qeveria.

Investimet kapitale: përbëjnë një pjesë të rëndësishme të shpenzimeve totale dhe, në periudhën afatmesme, pritet të arrijnë rreth 27% të tyre. Gjatë kësaj periudhe, planifikohet realizimi i projekteve kapitale të bazuara në prioritetet strategjike, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës së transportit, rrjetit energjetik, si dhe avancimin e kushteve në sektorët e arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, mbrojtjes dhe sigurisë, ndër të tjera. Pjesa më e madhe e këtyre investimeve pritet

të financohet nga buxheti i rregullt, ndërsa disa projekte në sektorë të ndryshëm do të mbështeten edhe përmes financimit të huamarrjes.

Përparësi në financim do t'u jepet projekteve që janë në fazë të zbatimit, si dhe atyre që janë në përputhje të plotë me prioritetet e Qeverisë. Kufijtë buxhetorë për investimet kapitale në organizatat buxhetore janë të natyrës indikative, ndërsa Qeveria rezervon të drejtën për t'i rishikuar dhe përshtatur ato në bazë të arsyeshmërisë dhe prioritizimit të projekteve të propozuara nga organizatat buxhetore.

5. Programi për investime publike (PIP)

Planifikimi buxhetor për investimet kapitale realizohet përmes rregullave dhe mekanizmave të Programit për Investime Publike (PIP). Prioritetet strategjike të Qeverisë shërbejnë si bazë për hartimin e kërkesave buxhetore dhe identifikimin e projekteve kapitale prioritare.

6. Indikatorët e performancës

Organizatat buxhetore, si në nivel qendror ashtu edhe në atë komunal, obligohen të paraqesin indikatorë të performancës të strukturuar sipas objektivave dhe aktiviteteve përkatëse organizative, në përputhje me nenin 21 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Çdo organizatë buxhetore duhet të përcaktojë nga 1 deri në 5 objektiva, të cilat lidhen drejtpërdrejt me strategjitë përkatëse dhe mbulojnë programet kryesore të institucionit.

Udhëzimi parasheh që, kur është e zbatueshme, të paktën një nga objektivat të fokusohet në promovimin e barazisë gjinore, i shoqëruar me indikatorë të performancës dhe aktivitete konkrete për realizimin e tij. Po ashtu, çdo kërkesë për mjete shtesë duhet të argumentohet qartë duke dëshmuar kontributin e saj në arritjen e objektivave të organizatës. Organizatat buxhetore duhet të rishikojnë aktivitetet e tyre në funksion të përmbushjes së objektivave të përcaktuara, ndërsa indikatorët për matjen e performancës duhet të jenë të qartë, të matshëm dhe specifikë për secilin aktivitet.

Forma e ofrimit të këtyre informatave dhe një shembull konkret janë dhënë në Aneksin 2. Për secilën organizatë buxhetore duhet të ofrohen informacionet e mëposhtme:

- **Objektivat e outputit:** Këto përshkruajnë rezultatet e pritshme nga ofrimi i shërbimeve, të cilat janë nën kontrollin e organizatës buxhetore.
- **Treguesit e outputit:** Këta tregues matnin aktivitetin e institucionit, si p.sh. sasinë apo cilësinë e shërbimit ose produktit të ofruar.
 - a) Indikatorit treguesi bazë
 - b) Indikatorit treguesi i synuar
- **Aktivitetet:** Këto përshkruajnë veprimet që do të ndërmerren për arritjen e objektivave të deklaruara.

7. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)

Në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës kanë obligim të integrojnë buxhetimin gjinor në të gjitha fushat, si instrument i domosdoshëm për garantimin e respektimit të parimit të barazisë gjinore në mbledhjen, shpërndarjen dhe alokimin e burimeve publike, në pajtim me nenin 5.1.5 të ligjit. Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të pasqyrojnë ndikimin e shpenzimeve publike në avancimin e barazisë gjinore në kuadër të buxhetit vjetor për vitin 2027. Një qasje e tillë kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit, llogaridhënies dhe transparencës në menaxhimin e financave publike.

Komunat duhet t'i marrin parasysh këto udhëzime gjatë hartimit të qarkores së brendshme buxhetore komunale, e cila do të shërbejë si bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2027–2029. Në rast të paqartësive, organizatat buxhetore mund të kërkojnë mbështetje nga analistët përkatës të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Forma dhe mënyra e paraqitjes së këtyre informatave janë përcaktuar në Aneksin 1. Gjithashtu, organizatat buxhetore obligohen që këto të dhëna t'i publikojnë në mënyrë transparente.

8. Kufijtë buxhetorë për Organizatat Buxhetore të Nivelit Qendror për periudhën 2027-2029

Organizatat buxhetore të nivelit qendror duhet t'i marrin parasysh kufijtë buxhetorë të paraqitur në tabelën në vijim gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2027 dhe projeksioneve për dy vitet pasuese.

Duhet të kihet parasysh se këta kufij buxhetorë mund të pësojnë ndryshime në varësi të zhvillimeve fiskale dhe vendimeve të Qeverisë, të cilat do të reflektohen përmes qarkoreve buxhetore pasuese, si dhe në bazë të cilësisë dhe arsyeshmërisë së kërkesave buxhetore të paraqitura nga organizatat buxhetore.

Në Tabelën 1 më poshtë paraqiten kufijtë buxhetorë për organizatat buxhetore të nivelit qendror për periudhën 2027–2029.

Shtojca 1. Shtojca , Vlersimet per vitet 2027-2029.

Kodi org.	Ministritë/Institucionet	Vlerësimet për vitin 2027							Vlerësimet për vitin 2028			Vlerësimet për vitin 2029			
		Numri Aprovuar	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe Transfere	Investimet Kapitale	Rrezerva	Total 2027	Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2028	Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2029
101	Kuvendi i Kosovës	528	8,543,763	1,858,000	200,000	70,000	200,000	-	10,871,763	11,141,670	200,000	11,341,670	11,637,421	200,000	11,837,421
102	Zyra e Presidentit	113	1,710,711	2,246,421	6,700	419,305	3,015,000	-	7,398,137	4,477,226	3,015,000	7,492,226	4,576,490	3,015,000	7,591,490
104	Zyra e Kryeministrit	609	5,856,852	4,221,147	88,226	7,505,687	1,500,000	-	19,171,912	17,994,038	1,500,000	19,494,038	18,333,882	1,500,000	19,833,882
201	Ministria e Financave	1,989	45,084,876	17,857,017	936,591	40,108,522	38,597,000	-	142,584,006	189,199,080	60,521,089	249,720,169	176,255,536	62,521,089	238,776,625
202	Ministria e Digitalizimit dhe Admin.Publike	325	3,968,806	15,554,272	2,574,550	500,000	32,897,045	-	55,494,673	23,140,472	25,705,045	48,845,517	20,348,819	25,705,045	46,053,864
203	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	937	8,698,998	6,500,000	314,783	77,630,000	5,544,000	-	98,687,781	93,622,226	5,544,000	99,166,226	94,126,986	5,544,000	99,670,986
204	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Inovacionit	325	3,117,712	9,386,000	108,280	8,296,000	14,320,000	-	35,227,992	21,078,158	14,320,000	35,398,158	21,258,991	14,320,000	35,578,991
205	Ministria e Infrastrukturaes dhe Transportit	300	3,032,381	26,337,800	350,990	1,443,814	228,571,272	-	259,736,257	32,785,346	209,708,024	242,493,370	32,961,286	209,708,024	242,669,310
206	Ministria e Shëndetësisë	1,482	19,911,589	38,702,600	351,848	800,000	43,887,400	-	103,653,437	61,268,743	60,591,711	121,860,454	62,424,113	57,469,411	119,893,524
220	Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves	7,538	107,072,722	69,700,000	4,639,016	-	22,449,500	-	203,861,238	187,600,738	23,000,000	210,600,738	193,813,633	23,000,000	216,813,633
207	Ministria e Kulturës dhe Turizmit	736	7,904,435	5,336,471	360,008	10,180,000	37,050,000	-	60,830,914	24,163,795	34,780,000	58,943,795	24,666,435	34,780,000	59,446,435
208	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	2,282	27,382,431	14,905,000	1,490,459	25,305,360	43,592,054	-	112,675,304	71,547,371	50,337,054	121,884,425	72,984,949	50,337,054	123,322,003
209	Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Lufës Çlirimtare	749	7,507,057	1,933,393	218,985	1,101,921,242	3,703,000	-	1,115,283,677	1,145,503,270	2,703,000	1,148,206,270	1,202,670,815	2,703,000	1,205,373,815
210	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor	354	3,668,033	17,419,045	130,500	200,000	65,233,373	-	86,650,951	17,358,455	58,103,918	75,462,373	-	-	-
211	Ministria për Komunitete dhe Kthim	121	1,163,405	380,000	12,000	2,100,000	2,000,000	-	5,655,405	3,719,392	2,000,000	5,719,392	3,786,898	2,000,000	5,786,898
212	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	129	1,316,189	435,000	7,000	1,000,000	4,050,000	-	6,808,189	2,830,580	4,050,000	6,880,580	2,906,951	4,050,000	6,956,951
213	Ministria e Ekonomisë	192	1,868,708	4,788,818	23,130	13,352,870	26,548,000	-	46,581,526	20,231,585	38,378,000	58,609,585	21,260,213	45,515,000	66,775,213
214	Ministria e Punëve të Brendshme	11,601	140,612,243	30,630,763	2,296,500	2,371,367	41,344,228	-	217,255,101	184,605,049	45,169,478	229,774,527	193,265,003	44,369,478	237,634,481
215	Ministria e Drejtësisë	2,149	22,642,077	12,499,590	1,109,769	6,050,000	10,200,000	-	52,501,436	43,553,298	7,000,000	50,553,298	44,867,740	7,000,000	51,867,740
216	Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diaspores	389	9,328,835	24,935,000	910,551	2,000,000	21,395,000	-	58,569,386	38,688,472	21,395,000	60,083,472	39,229,777	21,395,000	60,624,777
217	Ministria e Mbrojtjes	5,479	56,317,695	52,375,600	1,169,000	112,441,260	222,303,555	-	512,441,260	112,959,768	112,441,260	225,401,028	116,227,602	112,441,260	228,668,862
221	Ministria e Zhvillimit Rajonal	60	774,306	345,000	1,360	2,000,000	2,000,000	-	5,120,666	3,159,381	2,000,000	5,159,381	3,200,032	2,000,000	5,200,032
225	Ministria për Sport dhe Rini	120	1,409,053	1,677,530	23,900	6,936,550	79,390,000	-	89,437,033	10,224,850	95,660,000	105,884,850	10,304,569	98,660,000	108,964,569
230	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	42	541,009	310,000	5,000	-	100,000	-	956,009	885,765	100,000	985,765	917,157	100,000	1,017,157
231	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	20	304,766	930,000	5,000	790,159	-	-	2,029,925	2,046,688	-	2,046,688	2,064,372	-	2,064,372
235	Autoriteti i Rregullatorit i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	42	603,692	785,000	23,200	-	600,000	-	2,011,892	1,445,096	600,000	2,045,096	1,480,125	600,000	2,080,125
236	Agjencioni për parandalim dhe luftim te korruptcionit	58	876,879	147,500	6,000	-	-	-	1,030,379	1,078,607	-	1,078,607	1,129,488	-	1,129,488
238	Zyra Rregullatorit për Energi	41	621,049	370,000	22,000	-	80,800	-	1,093,849	1,047,207	80,800	1,128,007	1,103,244	80,800	1,184,044
240	Organi Shqyrtues i Prokurimit	35	413,375	160,000	5,100	-	-	-	578,475	601,210	-	601,210	625,196	-	625,196
242	Univerziteti i Prishtinës	2,081	24,858,161	4,600,000	1,370,000	1,944,000	5,400,000	-	38,172,161	34,139,360	5,400,000	39,539,360	35,581,754	5,400,000	40,981,754
243	Gjykata Kushtetuese e Kosoves	72	1,526,338	705,000	10,800	186,080	150,000	-	2,578,218	2,512,166	110,000	2,622,166	2,600,732	110,000	2,710,732
244	Autoriteti Kosovar i Konkurencës	30	414,813	80,000	2,000	-	-	-	496,813	521,628	-	521,628	545,697	-	545,697
245	Agjencioni Kosovar i Integritetit	190	8,667,595	4,000,000	45,000	700,000	4,270,000	-	17,682,595	14,039,313	4,500,000	18,539,313	14,542,250	4,500,000	19,042,250
246	Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore	18	290,594	107,000	4,050	-	-	-	401,644	417,627	-	417,627	435,989	-	435,989
247	Paneli Zgjedhor per Ankesa dhe Parashtesa	21	220,000	60,000	7,820	-	75,000	-	362,820	299,920	-	299,920	312,686	-	312,686
249	Këshilli i Pavarur Mbrojtës për Sherbimin Civil të Kosovës	38	530,273	180,000	3,825	-	-	-	714,098	743,263	-	743,263	774,032	-	774,032
250	Keshilli Prokurororial i Kosoves	969	14,598,523	3,694,759	299,116	14,400	2,534,500	-	21,141,298	19,415,357	2,534,500	21,949,857	20,262,436	2,534,500	22,796,936
302	Zyra Kombetare e Auditimit	185	2,813,595	876,100	40,000	-	-	-	3,729,695	3,884,443	-	3,884,443	4,047,702	-	4,047,702
313	Autoriteti Rregullativ i Sherbimeve të Ujit	21	275,015	145,000	6,503	-	-	-	426,518	442,041	-	442,041	462,102	-	462,102
314	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	29	320,498	127,000	6,400	-	-	-	453,898	471,525	-	471,525	490,122	-	490,122
317	Autoriteti i Aviacionit Civil	31	756,581	150,000	3,738	-	-	-	910,319	948,148	-	948,148	987,868	-	987,868
318	Komisioni i Pavarur i Minerave dhe Mineraleve	77	1,017,077	409,281	20,600	-	200,000	-	1,646,958	1,552,897	200,000	1,752,897	1,611,913	200,000	1,811,913
319	Komisioni i Pavarur i Mediave	44	587,266	419,883	18,000	-	80,000	-	1,105,149	1,057,449	-	1,057,449	1,091,525	-	1,091,525
320	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	93	1,337,150	700,000	28,100	5,180,320	-	-	7,245,570	7,339,113	-	7,339,113	7,416,701	-	7,416,701
321	Institucioni i Avokatit të Popullit	78	1,125,194	357,000	7,000	-	67,000	-	1,556,194	1,551,080	60,000	1,611,080	1,616,369	60,000	1,676,369
322	Akademia e Drejtësisë	32	355,011	535,000	16,500	-	900,000	-	1,806,511	926,037	-	926,037	946,637	-	946,637
328	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2,321	29,804,863	5,648,000	1,049,864	500,000	3,920,000	-	40,922,727	38,642,995	3,920,000	42,562,995	40,372,422	3,920,000	44,292,422
329	Agjencia Kosovare për krahasim dhe Verifikim të Pronës	200	1,947,398	851,090	58,523	-	431,500	-	3,288,511	2,964,118	431,500	3,395,618	3,077,116	431,500	3,508,616
251	Agjensioni per Informim dhe Privatesi	34	410,130	154,000	2,450	-	-	-	566,580	589,137	-	589,137	612,935	-	612,935
232	Shpenzimet e Paparashikuara						1,930,000	10,000,000	11,930,000	10,000,000	1,930,000	11,930,000	10,000,000	1,930,000	11,930,000
248	Radio Televizioni i Kosovës					8,960,000	-	-	8,960,000	8,960,000	-	8,960,000	8,960,000	-	8,960,000
224	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	52	538,042	400,000	25,000	10,000,000	-	-	10,963,042	11,042,634	-	11,042,634	11,073,854	-	11,073,854
255	Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar	25	439,262	290,000	7,000	-	150,000	-	886,262	760,422	150,000	910,422	785,910	150,000	935,910
239	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	234	3,867,574	1,025,000	130,000	2,000	20,000	-	5,044,574	5,237,291	20,000	5,257,291	5,461,707	20,000	5,481,707
	Totali i përgjithshëm	45,620	588,954,602	388,241,080	20,552,735	1,338,467,676	860,836,932	10,000,000	3,207,053,025	2,496,415,500	898,159,379	3,394,574,879	2,552,498,182	848,270,161	3,400,768,343

9. Fazat e Procesit Buxhetor për vitin 2027 për nivelin qendror

Pjesa në vijim paraqet kalendarin buxhetor, hapat dhe aktivitetet kryesore gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit për vitin 2027. Datat që bien në fundjavë janë përshtatur në ditën më të afërt të punës.

- **15 Maj 2026** – Lëshimi i Qarkores së parë buxhetore 2027/01. Kjo qarkore përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetorë dhe kalendarin buxhetor.
- **26 Qershor 2026** – Organizatat buxhetore duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Financave (MF) kërkesat buxhetore sipas dokumentacionit përkatës, duke përshkruar programet dhe kategoritë e shpenzimeve. Kërkesat duhet të jenë të plota dhe të arsyetuara përmes sistemit të SZHMB-së dhe PIP-it.
- **26 Qershor 2026** – Departamenti i Makroekonomisë paraqet kornizën e re makro-fiskale, e cila përcakton parametrat e të hyrave dhe shpenzimeve për vitin buxhetor 2027.
- **10 Korrik 2026** – Lëshimi i Qarkores së dytë buxhetore 2027/02, e cila do të adresojë çështjet specifike të reja të paraqitura pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore.
- **24 Korrik 2026** – Nëse kërkohen informata shtesë sipas Qarkores së dytë buxhetore, ato duhet të dorëzohen nga organizatat buxhetore në Ministrinë e Financave – Departamentin e Buxhetit deri në këtë datë.
- **21 Gusht – 28 Gusht 2026** – Dëgjimet buxhetore. Pas pranimi të materialeve nga organizatat buxhetore, do të zhvillohen dëgjime me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave buxhetore, stafit të MF-së, Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Komisionit Parlamentar për Buxhet. Orari i dëgjimeve do t'i bashkëngjitet Qarkores buxhetore 2027/02. Gjatë këtyre dëgjimeve mund të shqyrtohet edhe arritja e marrëveshjes për shumën totale të buxhetit të organizatës për vitin 2027.
- **11 Shtator 2026** – Departamenti i Politikave Ekonomike paraqet vlerësimet e fundit për indikatorët makroekonomikë, veçanërisht ata që lidhen me procesin buxhetor 2027–2029.
- **17 Shtator – 22 Shtator 2026** – Konsultime në Qeveri për përcaktimin e kufijve finalë buxhetorë. Gjatë kësaj periudhe do të diskutohen dhe përcaktohen kufijtë përfundimtarë të buxhetit.
- **25 Shtator 2026** – Lëshimi i Qarkores së tretë buxhetore, e cila do të përmbajë kufijtë finalë buxhetorë. Këta kufij mund të ndryshojnë nga ata të përcaktuar në Qarkoren e parë dhe të dytë.
- **30 Shtator – 3 Tetor 2026** – Organizatat buxhetore mund të paraqesin ankesat lidhur me kufijtë buxhetorë të përcaktuar.
- **7 Tetor – 12 Tetor 2026** – Takimet e Qeverisë për shqyrtimin e ankesave të organizatave buxhetore dhe vendimmarrjen mbi çështjet e ngritura gjatë procesit të shqyrtimit.
- **19 Tetor 2026** – Drafti i parë i Buxhetit për vitin 2027 paraqitet në Ministrinë e Financave dhe dërgohet në Qeveri për shqyrtim.
- **20 Tetor – 23 Tetor 2026** – Miratimi final i Draft-Buxhetit në Qeveri. Pas shqyrtimit, Qeveria miraton buxhetin përfundimtar për vitin 2027.
- **29 Tetor 2026** – Dorëzimi i Draft-Buxhetit 2027 në Kuvendin e Republikës së Kosovës për miratim.

Kërkesa buxhetore e organizatave buxhetore të nivelit qendror duhet të përfshijë këto dokumente dhe informata përcjellëse:

- Tabelën me parashikimet deri në fund të vitit të implementimit të buxhetit 2026, në nivel programi dhe nën-programi, së bashku me komentet shpjeguese lidhur me nën-ekzekutimin apo mbi-ekzekutimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2026;
- Tabelat 3.1, 3.1A dhe 3.1B, si dhe formularët përkatës të PCF-ve të gjeneruar nga sistemi i SZHMB-së;
- Tabelat 3.2 dhe 3.2B, si dhe formularët e gjeneruar nga Sistemi i Programit për Investime Publike (PIP);
- Tabelat për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ);
- Tabelën e buxhetimit të bazuar në performancë;

- Kërkesën buxhetore të konsoliduar në nivel të organizatës buxhetore, duke përfshirë edhe agjencitë ekzekutive në kuadër të saj;
- Shkresën përcjellëse të nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm ose Kryeshefi Ekzekutiv i agjencisë, e cila duhet të shoqërojë të gjitha materialet buxhetore;
- Përshkrimin narrativ të kërkesës buxhetore, i cili duhet të përfshijë:
 - arritjet e deritanishme, me theks të veçantë në realizimin e objektivave të përcaktuara në dokumentet strategjike;
 - rezultatet që synohen të arrihen përmes ndarjeve buxhetore për vitin 2027 dhe projeksioneve për vitet 2028–2029;
 - sqarime nëse kërkesa buxhetore parasheh vazhdimin e politikave ekzistuese, përfundimin e aktiviteteve aktuale, apo inicimin e aktiviteteve dhe politikave të reja.

Për aktivitetet e reja, organizatat buxhetore duhet të përcaktojnë në mënyrë të qartë bazën ligjore përkatëse, si koncept dokument, udhëzim administrativ, projektligj apo akte të tjera relevante. Po ashtu, ato duhet të informojnë nëse është realizuar Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor për këtë bazë ligjore, në përputhje me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 09/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2015 për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare.

Buxheti Komunal

1. Hyrje

Me këtë dokument përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2027 dhe orientimet për vitet 2028-2029, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2027 si dhe parashikimin afatmesëm 2028-2029.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2027, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxheti në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

Projektet kapitale shumëvjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë. Si rrjedhojë, nga komunat kërkohet të hartojnë strategjinë kornizë bazuar në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate.

2. Burimet e Financimit Komunal për vitin 2027-2029

2.1. *Granti i Përgjithshëm*

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike i Ministrisë së Financave në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2027 është në shumë prej 370.43 milion euro.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet të Departamentit të Politikave Ekonomike, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2027 pritet të jenë 3,871.6 mil. euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2027 është në shumë prej 370.43 milion euro.

Gjithashtu, në kuadër të Grantit të përgjithshëm është shtuar shuma prej 14.57 milionë euro si rezultat i ndikimit negativ në grantet operative (Granti i përgjithshëm, Granti specifik për Arsim dhe Granti specifik për shëndetësi), me rastin e regjistrimit të popullsisë duke u bazuar në nenin 35.3 të Ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.

Për rrjedhojë Granti i përgjithshëm për vitin 2027 arrin shumën totale prej 385 milionë euro.



Tabela 1: Përcaktimi i vlerës së Grantit të Përgjithshëm për komuna 2027-2029 (mil. Euro)

Përshkrimi	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë	2,985.32	3,227.19	3,544.30	3,871.61	4,154.02	4,476.35
Zbriten:						
Mbeshtetja buxhetore dhe grante	(18.0)	(22.5)	(22.5)	(22.5)	(22.5)	(22.5)
Tatimi në pronë	(49.3)	(45.0)	(50.0)	(55.0)	(55.5)	(59.0)
Të hyrat nga dividendat				(10.0)	(10.0)	(10.0)
Grantet e percaktuara të donatorëve	(12.0)	(12.0)	0.0	0.0	0.0	0.0
Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale	(56.2)	(70.0)	(73.5)	(77.2)	(81.0)	(87.8)
Të hyrat nga interesi	(3.0)	(2.8)	(13.0)	(2.7)	(2.4)	(2.0)
B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm	2,846.80	3,074.89	3,385.26	3,704.28	3,982.63	4,295.07
C. Granti i përgjithshëm për komuna (10%)	284.68	307.49	338.53	370.43	398.26	429.51

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Tabela 2: Struktura e Grantit të Përgjithshëm për 2027-2029 sipas LFPL (mil. Euro)

Faktorët	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
Granti i përgjithshëm	284.68	307.49	345.02	385.0	398.3	429.5
Diferenca e ndikuar negativisht në grantet operative			6.5	14.6		
Shuma Fikse	3.6	3.6	3.8	3.8	3.8	3.8
Popullsia (banorë)	1,780,021	1,780,021	1,602,515	1,602,515	1,602,515	1,602,515
Buxheti: 89% e shumës agregate	250.1	270.4	297.9	326.3	351.1	378.9
Zona komunale (km ²)	10,901	10,901	10,905	10,905	10,905	10,905
Buxheti: 6% e shumës agregate	16.9	18.2	20.1	22.0	23.7	25.5
Komunitetet pakicë në komunë	107,926	107,926	115	115	115	115
Buxheti: 3% e shumës agregate	8.4	9.1	10.0	11.0	11.8	12.8
Popullsia e komunave pakicë	62,031	62,031	45,756	45,756	45,756	45,756
Buxheti: 2% e shumës agregate	5.6	6.1	6.7	7.3	7.9	8.5

Tabela 3 në vijim paraqet shpërndarjen e Grantit të Përgjithshëm nëpër komuna sipas formulës të paraparë në LFPL.

Tabela 3: Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm në komuna 2027-2029

Komunat		Kriteret për ndarjen e Grantit të Përgjithshëm (sipas LFPL)											Diferenca e ndikuar negativisht në grantet operative	Granti i përgjithshëm për vitin 2027	Granti i përgjithshëm për vitin 2028	Granti i përgjithshëm për vitin 2029		
		Popullsia		Madhësia gjeografike		Popullsia Pakicë		Komunat me popullsi pakicë		Shuma Fikse (140,000-1€)	Shuma për Popullsi (89 %)	Shuma për madhësi gjeografike (6 %)					Shuma për popullsi pakicë në komuna (3 %)	Shuma për Komunat me popullsi pakicë (2 %)
		Popullsia	89 %	Madhësia gjeografike	6 %	Popullsia Pakicë në Komuna	3 %	Komunat me popullsi pakicë	2 %									
1	Deçan	27,775	1.73%	293.97	2.70%	509	0.44%		0.00%	112,225	5,655,269	592,966	48,683	-	1,110,024	7,519,168	6,887,235	7,423,868
2	Dragash	28,896	1.80%	433.85	3.98%	11,342	9.86%		0.00%	111,104	5,883,516	875,118	1,084,803	-	735,003	8,689,544	8,550,051	9,218,480
3	Ferizaj	109,255	6.82%	344.61	3.16%	4,230	3.68%		0.00%	30,745	22,245,417	695,112	404,577	-	0	23,375,852	25,148,319	27,137,824
4	Fushë Kosovë	63,949	3.99%	84.09	0.77%	5,548	4.82%		0.00%	76,051	13,020,660	169,618	530,637	-	0	13,796,966	14,838,720	16,008,037
5	Gjakovë	78,699	4.91%	586.64	5.38%	6,603	5.74%		0.00%	61,301	16,023,908	1,183,310	631,542	-	1,477,946	19,378,008	19,254,462	20,774,708
6	Gjilan	82,980	5.18%	391.84	3.59%	2,338	2.03%		0.00%	57,020	16,895,563	790,380	223,617	-	836,847	18,803,427	19,326,356	20,852,635
7	Glllogoc	48,079	3.00%	275.63	2.53%	43	0.04%		0.00%	91,921	9,789,368	555,973	4,113	-	28,921	10,470,295	11,227,152	12,109,148
8	Hani i Elezit	8,533	0.53%	83.13	0.76%	16	0.01%		0.00%	131,467	1,737,405	167,681	1,530	-	0	2,038,083	2,182,842	2,345,327
9	Istog	33,008	2.06%	454.36	4.17%	3,116	2.71%		0.00%	106,992	6,720,761	916,488	298,029	-	0	8,042,270	8,644,753	9,321,010
10	Junik	3,943	0.25%	77.76	0.71%	5	0.00%		0.00%	136,057	802,834	156,850	478	-	86,324	1,182,544	1,169,119	1,250,946
11	Kaçanik	27,716	1.73%	211.27	1.94%	31	0.03%		0.00%	112,284	5,643,256	426,152	2,965	-	154,611	6,339,269	6,645,700	7,163,197
12	Kamenicë	22,868	1.43%	416.61	3.82%	2,310	2.01%		0.00%	117,132	4,656,155	840,343	220,939	-	2,934,569	8,769,138	6,268,663	6,755,912
13	Klinë	30,503	1.90%	309.02	2.83%	1,352	1.18%		0.00%	109,497	6,210,718	623,324	129,312	-	359,737	7,432,586	7,601,540	8,194,967
14	Leposaviq	9,485	0.59%	539.05	4.94%	837	0.73%	9,485	20.73%	130,515	1,931,241	1,087,316	80,055	1,519,955	83,541	4,832,623	5,099,745	5,493,346
15	Lipjan	55,044	3.43%	338.41	3.10%	3,183	2.77%		0.00%	84,956	11,207,512	682,606	304,437	-	140,707	12,420,218	13,205,378	14,244,616
16	Malishevë	43,888	2.74%	306.44	2.81%	71	0.06%		0.00%	96,112	8,936,038	618,119	6,791	-	199,161	9,856,221	10,382,971	11,197,770
17	Mamushë	5,607	0.35%	10.94	0.10%	387	0.34%	5,607	12.25%	134,393	1,141,642	22,067	37,015	898,512	0	2,233,628	2,393,012	2,571,912
18	Mitrovicë	64,742	4.04%	330.72	3.03%	2,049	1.78%		0.00%	75,258	13,182,123	667,095	195,976	-	408,624	14,529,076	15,186,826	16,383,779
19	Novo Bërdë	4,493	0.28%	203.98	1.87%	692	0.60%		0.00%	135,507	914,820	411,448	66,186	-	239,460	1,767,421	1,633,682	1,752,349
20	Obiliq	22,815	1.42%	104.84	0.96%	3,573	3.11%		0.00%	117,185	4,645,364	211,473	341,739	-	0	5,315,760	5,710,459	6,153,490
21	Pejë	82,745	5.16%	602.58	5.53%	7,266	6.32%		0.00%	57,255	16,847,715	1,215,463	694,955	-	370,353	19,185,740	20,239,590	21,838,187
22	Podujevë	70,975	4.43%	632.59	5.80%	904	0.79%		0.00%	69,025	14,451,224	1,275,996	86,463	-	196,172	16,078,879	17,083,355	18,431,021
